



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 1541 Prot

Shkodër, më 07 . 05 .2024

Lënda: "Përcillet për njohje dhe zbatim Urdhëri nr.28, datë 30.04.2024 i Rektorit të USH-së"

FAKULTETEVE TË USH-së

DEPARTAMENTEVE TË USH-së

ADMINISTRATORIT TË USH-së

STUDENTËVE TË USH-së

Bashkëngjitur po ju dërgojmë Urdhërin nr.28, datë 30.04.2024 i Rektorit të USH-së "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Shkodrës".

Të merren të gjitha masat ligjore nga ana juaj për fillimin e procesit zgjedhor sipas detyrave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.106 datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së, (e ndryshuar), për strukturat dhe autoritetet e ngarkuara dhe në respektim të afateve të përcaktuara.

Në zbatim të neneve 6 dhe 37 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.106 datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së, (e ndryshuar), të njoftohet i gjithë personeli akademik i USH-së dhe studentët me kohë të plotë të fakulteteve përkatëse, për të paraqitur kandidaturën e tyre për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve në USH dhe të Komisionit të Apelit të USH-së, pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të USH-së, **nga data 7.05.2024 deri me datë 10.05.2024 (nga ora 8: 00- 16: 00).**

Aplikimi për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), që do të bëhet nga studentët, duhet të jetë i shoqëruar edhe me një vërtetim studentit të lëshuar nga fakulteti përkatës.

Kandidatët që aplikojnë për anëtarë të Komisionit të Apelit të USH-së, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 37, pika 2 e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës”.

Bashkëngjitur gjeni modelet e formularit të vetëkandidimit.

Të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana juaj për zhvillimin e këtij procesi në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës”, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.106 datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së, (e ndryshuar).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 1479 Prot

Shkodër, më 30 . 04 .2024

URDHËR

Nr. 28 , Datë 30 . 04 .2024

"PËR SHPALLJEN E DITËS SË FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS"

Bazuar në nenin 36 pika 7 dhe nenin 39 të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", neni 5 pika 3; si dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese ne Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", në cilësinë e titullarit të institucionit:

URDHËROJ

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Shkodrës, është data 21 Maj 2024.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Shkodrës, është data 21 Qershor 2024.
3. Ky Urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim të gjitha njësive kryesore dhe njësive të tjera në përbërje të Universitetit të Shkodrës.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. Rejmonda Këc
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Shkodër, më ____ . ____ .2024

**FLETË APLIKIMI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ)**

Në zbatim të nenit 6 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit akademik në Universitetin e Shkodrës", të miratuar me Vendimin me Nr. 106, datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së (e ndryshuar), unë , i/e nënshkruari/a, z/znj. _____, personel akademik me kohë të plotë në Fakultetin

_____, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi, aplikoj për të qënë anëtar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

Në zbatim të nenit 6 të Rregullores së lartpërmendur, deklaroj se:

- Kam përvojë pune në mësimdhënie me kohë të plotë;
- Nuk kam qënë asnjëherë i/e dënuar për vepra penale, me vendim të formës së prerë;
- Nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe SA.

Emër, mbiemër, firma

Shënim:

Personeli akademik që do të vetëkandidojë, duhet t'i bashkëngjisë këtij aplikimi fotokopje të një dokumenti identifikimi.



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Shkodër, më ____ . ____ .2024

FLETË APLIKIMI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE (KIZ)

Në zbatim të nenit 6 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Shkodrës", të miratuar me vendimin e Senatit Akademik të USH-së nr. 106, datë 20. 02. 2020 (e ndryshuar), unë, i/e nënshkruari/a z/znj. _____, student në Fakultetin _____, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", aplikoj për të qënë anëtar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

Në zbatim të nenit 6 të Rregullores së lartpërmendur, deklaroj se:

- Jam student në Fakultetin _____, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi",
- Nuk kam qënë asnjëherë i/e dënuar për vepra penale, me vendim të formës së prerë;
- Nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe SA.

Emër, mbiemër, firma

Shënim: Çdo student/e që do të vetëkandidojë, duhet t'i bashkëngjisë këtij aplikimi fotokopje të një dokumenti identifikimi dhe një vërtetim i lëshuar nga fakulteti përkatës, që vërteton që është student me kohë të plotë në atë fakultet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Shkodër, më ____ . ____ .2024

FLETË APLIKIMI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË APELIMIT (KA)

Në zbatim të nenit 37, pika I të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.106 datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së, (e ndryshuar), unë i/e nënshkruari/a z/znj. _____, Përsoneel akademik me kohë të plotë në Fakultetin _____, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", aplikoj për të qënë Anëtar i Komisionit të Apelimit (KA).

Në zbatim të nenit 37 pika 2 e Rregullores së lartpërmendur, deklaroj se:

- Kam përvojë pune në mësimdhënie me kohë të plotë;
- Nuk kam qënë asnjëherë i/e dënuar për vepra penale, me vendim të formës së prerë;
- Nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe SA;

Emër/ Mbiemër/ Firma

Shënim:

Përsoneeli akademik që do vetëkandidojë, duhet t'i bashkangjisë këtij aplikimi një fotokopje të dokumentit të identifikimi, Kartë ID ose Pasaportë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Shkodër, më ____ . ____ .2024

FLETË APLIKIMI PËR SEKRETAR/E TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE (KIZ)

Në zbatim të nenit 6, pika 1, gërma a), të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.106 datë 20.02.2020 të Senatit Akademik të USH-së, (e ndryshuar), unë i/e nënshkruari/a z/znj. _____, personel akademik me kohë të plotë në Fakultetin _____, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", aplikoj për të qënë Sekretar/e i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

Në zbatim të nenit 6 pika 1 e Rregullores së lartpërmendur, deklaroj se:

- Nuk kam qënë asnjëherë i/e dënuar për vepra penale, me vendim të formës së prerë;
- Nuk kandidoj për autoritet drejtues dhe SA;

Emër/ Mbiemër/ Firma

Shënim:

Përsonei akademik që do vetëkandidojë, duhet t'i bashkangjisë këtij aplikimi një fotokopje të dokumentit të identifikimi, Kartë ID ose Pasaportë.